Ne kuader te Drejtoris se Sherbimeve Publike behet percaktimi dhe ofrimi i sherbimeve komunale per qytetare,koordinimi i puneve me nderrmarrjet publike qendrore dhe nderrmarrjet publike komunale. Drejtoria per Sherbime Publike gjithashtu do te merret me mirmbajtjen dhe riparimin e rrugeve(verore dhe dimerore),mirmbajtjen e siperfaqeve te gjelbruara,mirmbajtjen e rrjetit te ndriqimit publik,mirmbajtjen e rrjetit te kanalizimit te ujrave te zeza dhe atyre atmosferike,shenjezim horizontal dhe vertikal dhe rregullimin e transportit publik, funksionimin e tregjeve,mirmbajtjen e varrezave dhe lapidareve si dhe ne perspektiv me sistemet e nxemjes qendrore dhe energjin ekologjike.

Sektori për Inspektorat

Sektori për Inspektorat bënë mbikëqyrjen e prodhimeve me origjinë bimore dhe shtazore, në sferën e qarkullimit të mallrave, hotelerisë, ndërtimtarisë, komunikacionit, bujqësisë, shëndetësisë humane dhe atë shtazore- kushtet higjenik- sanitare, ambienti të mbështetura në Ligje dhe akte nënligjore si dhe në Rregulloret Komunale dhe ato qendrore. Mbrojtja e punëtorit në punë , Mbrojtja dhe masat nga sëmundjet në Shëndetësi, Bujqësi, Ambient, Komunikacion Shërbime Publike

Zyrtari per Sherbime Publike

Pranon kerkesat ose ankesat e palëve dhe udhëheq procedurat administrative për shqyrtimin e tyre nga Sektori për Sherbime Publike.

Zbaton ligjin, rregulloret dhe vendimet me të cilat rregullohet lëmia e shërbimeve publike.

Kujdeset për avancimin dhe mbarevajtjen e rregullt të punës në zyrë, bënë klasifikim dhe renditjen e dokumenteve, i ruan dhe jep informata të kërkuara zyrtareve komunal si dhe paleve për kerkesat e tyre. Kujdeset për vendosjen dhe heqjen e flamujve ose reklamave në hapsirat publike qoftë me rastin e festave, ditëve të shënuara ose ditëve të rendomta.

Kryen pagesën e taksave nga shitesit e tregut dhe u jep atyre tiketat për pagesën e kryer në baze të rregullores

Kujdeset për mirmbajtjen dhe dukshmerin sa më të bukur të objekteve publike siq janë: objekte perkatesisht pllakat perkujtimore të deshmoreve, varrezat e deshmoreve, bustet dhe permendoret.

-Administrata

Deklarata e Misionit: Administrata siguron të gjitha procedurat, udhëzimet dhe politikat për implementimin sa më të mirë të aktiviteteve të kësaj drejtorie, menaxhon me stafin, Inspektorët, buxhetin dhe financat e kësaj drejtorie.

- Sektori për Inspektoriat

-Inspektori i ndërtimtarisë

Deklarata e misionit: Bënë mbikëqyrjen e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit të objekteve të cilat vendosen, ndryshohen, rrënohen dhe mirëmbahen që të mos rrezikojnë sigurinë, qarkullimin e lirë, shëndetin dhe mjedisin/ambientin, duke ju përmbajtur vijës së ndërtimit sipas projektit kryesor.

-Inspektori për shërbime publike dhe komunikacion

Deklarata e misionit: Bënë mbikëqyrjen dhe ndërmerr masa për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm, pastrimin e qytetit, sipërfaqeve publike, rrugëve dhe trotuareve, kanalet e ujërave të zeza, kanalet atmosferike, rrjetit të ujësjellësit, pastrimin e parqeve në qytet, ndriçimin publik të qytetit si dhe pastrimin e tregut dhe të pusetave.

Deklarata e misionit: Inspekcioni i komunikacionit bënë mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e kompanive publike transportuese në sektorin privat dhe publik rreth kushteve higjieno-teknike. Mbajtjes së vijave sipas orarit si dhe pajisjes së tyre me aparate adekuate rreth fikjes së zjarrit.

-Inspektori Sanitar dhe i ambientit

Deklarata e misionit: Bënë mbikëqyrjen e kualitetit të ushqimit dhe produkteve të ambalazuara dhe jo të ambalazuara, objektet prodhuese dhe të paketimit të produkteve ushqimore, mbikëqyrë furnizimin me ujë të pijes dhe të kualitetit të tij, harton programin e mostrimit të ujit në burimet publike dhe në puset private. Zbaton masa parandaluese mbi rrezikun e shëndetit publik, mbikëqyrë ujrat e pishëm, dhe qendrat rekreative, kontrollon dhe inspekton objektet e prodhimit të ushqimit dhe produktet tjera të konsumit. Konstaton afatin e përdorimit të produkteve ushqimore, si dhe produkteve biologjike dhe kimike si dhe jep Udhëzime për kushtet e ruajtjes së tyre. Bashkëpunon ngusht me Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës.

-Inspektori i tregut

- Deklarata e misionit: ndërmerr masa për marrjen e lejeve, mbajtjen e librave për të cilët kanë leje të regjistrimit, vendosja e çmimeve në vend të duhur, duke përfshirë transparencën e firmës si dhe të orarit të punës. Bënë kontrollimin e produkteve ushqimore lidhur me qëndrueshmërinë, gjegjësisht skadimin e afatit të mallrave. Bashkpunon me të gjitha insitucionet qeveritare, joqeveritare, shkencore, organizata profesionale etj. me qëllim të funksionimit efikas të drejtorisë,

-Inspektori i bujqësisë

Deklarata e misionit– Mbikëqyrë bizneset që merren me qarkullimin e repromaterialit bujqësor duke përfshirë pesticidet, farërat dhe plehrat, mbikëqyrë fushatën e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore si dhe bënë mbikëqyrjen e produkteve ushqimore me prejardhje bimore.

Kategoritë buxhetore

		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	42485	47697	52697
2.	Mallra dhe shërbime	53826	83826	113826
3.	Shpenzime komunale	283000	106000	200000
4.	Kapitale	62000	70171	75171
	Gjithsej			

Kategorit kryesore të performances

	2021	2022	2023
Kuantitative			
Inspektorati do të bëj 900-1000 inspektime të bizneseve. Inspektimet do të jenë të rregullta dhe jashtëzakonshme. Pranimin e kërkesave të qytetarëve dhe shqyrtimi i tyre			
Kualitative			
1. Do të ofroj informacione dhe këshilla për bizneset lidhje me zbatimin e ligjeve në fuqi. 2. Me zbatimin e ligjeve krijohen kushtet për zhvillimin e veprimtarive dhe mbrojtjen e konsumatorit në anën tjetër. 3. Përcjellja permanente e kualitetit të ujërave të pijes dhe atyre rrjedhëse, kushteve higjenik-sanitare 4. Kontrolli dhe përcjellja e produkteve ushqimore dhe qarkullimi i tyre, kushtet e ruajtjes, afati i përdorimit. 5. Qarkullimi publik i qytetarëve si në sektorin shoqëror po ashtu edhe atë privat . 6. Mbrojtja e mjedisit nga ndotësit e ndryshëm. 7. Mbikëqyrja e në qarkullimin e pesticideve dhe inputeve bujqësore etj. 8. Ndërtimi i planifikuar brenda zonave urbane.			

- Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

Deklarata e misionit: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim është përgjegjëse që të merr masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive si dhe përcjellë aktivitetet e subjekteve relevant dhe involvues (duke përfshirë edhe organizatat jo qeveritare të cilët do të mbështesin **shërbimet emergjente** në rast fatkeqësie.

-Menagjimin e emergjencave të nivelit Komunal, vënien e standardeve të kryerjes së punës lidhur me gatishmërinë civile dhe reagimit emergjent në teritorin e Komunës dhe koordinimin e subjekteve relevante për reagim në situatë emergjente, varsisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë.

Zyra për alarmim dhe koordinim

DEKLARATA E MISIONIT: Të mirëmbajë komunikimet me publikun, policinë, administratën komunale, reaguesit tjerë ndaj emergjencave dhe qytetarëve 24 orë në ditë dhe bënë dërgimin e forcës njerëzore dhe të pajisjeve të emergjencave në mënyrë të shpejtë dhe me kohë.

Administrata

Deklarata e misionit: Administrata siguron drejtimin dhe koordinon me nivelin qendror dhe agjencionet tjera për emergjencë, siç janë: IPVQ, KFOR, SHPK, TMK dhe donatorët ndërkombëtar. Administrata l njofton drejtoritë tjera për thyerjen e kodit dhe kërkon mbylljen e rrugëve, ndërtesave, fabrikave, ose sferave tjera, ku rreziku për shëndetin dhe pronën është i pashmangshëm. Administrata menaxhon të gjitha detyrat fiskale dhe zbaton politikat, procedurat dhe veprimet për personelin.

Zyra e preventivës dhe hulumtimit

DEKLARATA E MISIONIT: Zyra e Preventivës dhe Hulumtimit promovon sigurinë publike duke administruar kodet dhe standardet e zjarrit, kryerjen e rregullt të inspektimit të ndërtesave dhe sigurimin e shpejtë të hulumtimit dhe zbatimin e thyerjeve të kodeve. Divizioni punon në pajtim me rregulloret e nivelit qendror në lidhje me zjarret, dëmet ambiente, dhe dëmet natyrore përmes inspektimit, raportimit aktivitetesh zbatuese të gjera. Zyra e Preventivës dhe Hulumtimit edukon publikun, posaçërisht rininë, në lidhje me rreziqet potenciale dhe parandalimin e tyre. Divizioni hulumton dhe regjistron raportet që kanë të bëjnë me shkaqet dhe përgjigjen kundër situatave emergjente.

Brigada e zjarrëfiksëve

DEKLARATA E MISIONIT: Brigada e Zjarrëfiksëve i mbron jetrat dhe pronat e qytetarëve të Komunës së Shtimes. Brigada e Zjarrëfiksëve përgjigjet ndaj të gjitha emergjencave dhe ndërmerr veprime preventive për të siguruar se situatat emergjente nuk përkeqësohen. Si Përgjigjja e parë emergjente në Komunën e Shtimes, Brigada e Zjarrëfiksëve koordinon qendrën e saj përgjegjëse me zyrtarët e Policisë, Ndhmës së parë, ushtrisë dhe administratës civile, për të siguruar mbrojtjen më efektive të jetrave dhe pronës.

Kategoritë buxhetore		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	85209	90635	95635
2.	Mallra dhe shërbime	9282	8282	8282
3.	Transfere dhe subvencione			
4.	Kapitale			
5.	Komunali	2961	2961	3961
*	Totali:			

Kategoritë kryesore të performances	2021	2022	2023
Kuantitative			
1. do të përfundojmë projekt planet e zyrës për emergjencë siqë janë -plani i përgjithshëm për gatishmëri emergjente - project plani për mbrojtjen nga epidemit - project plani për mbrojtjen nga vërshimet - project plani për mbrojtjen nga zjarret në komunën e Shtimes dhe projekt plani për mbrojtjen nga mjetet e pashpërthyer të metura nga 2. Do të bëjmë perpjekje për sigurimin e automjeteve për brigaden e Zjarrfikësve, dhe rritjen e numrit të punëtorëve lufta (MINAT).			
Kualitative			
1. Sigurimi i automjeteve do të kontriboj në rritjen e efikasiteteve në për intervenime të shpejta dhe parandalimin e eskalimit të rasteve emergjente në radhe të pare për të siguruar mbrojtjen e jetrave të njerzve dhe të mirave materjale 2. Do të mundësohet që project planet për komunën tone të jenë të aplikueshme dhe njëherit qytetarët që kërkojnë ndihmë të jemi më afër për tju dal në nihmë për kërkesat e tyre. 3. do të kontribojmë për një të ardhme më të mir dhe siguri të plotë për të gjithë.			

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

Deklarata e misionit: Drejtori, Ofron ndihmën profesionale Kuvendit Komunal, organeve të tijë dhe Kryetarit të komunës në procesin e vendimarrjes. • Ndërmerr iniciativa dhe i propozon Kuvendit për miratim: Rregullore, Vendime, Projekte, Kontrata, Konkluzë si dhe projekte ose akte tjera nga lëmia e drejtorisë. • Zbaton Ligjet dhe implementon: vendimet, rregulloret, projektet, urdhëresat dhe dokumentet tjera të aprovuara nga Kuvendi Komunal. • Udhëheqë, organizon, dhe kontrollon kryerjen e punëve në Drejtorinë për Planifikim Hapësinor dhe Mjedis, • Propozonë dhe merr pjesë në zgjedhjen e kuadrit profesional të drejtorisë, • Bënë kordinimin e punëve dhe cakton nivelin e prioriteteve për kryerjen e punëve, • Bashkpunon me të gjitha insitucionet qeveritare, joqeveritare, shkencore, humanitare, organizata profesionale etj. me qëllim të funksionimit efikas të drejtorisë, • Nënshkruan dhe mbikqyrë implementimin e kontratave për punët në drejtori, • Raporton Kuvendit për punën e kryer në drejtori sipas afateve të prapara kohore,
--

- Është përgjegjëse për zhvillimin funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës komunale.

1.Sektori i Urbanizmit dhe Ndërtimit

Deklarata e misionit: Të shpallet detyra projektuese për Hartimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Komunal. Të përmirësoj infrastrukturën përmes projekteve kapitale të financuara nga Të hyrat Vetanake, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe Donatorët.

Të implementohet Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban 2009-2020.

Angazhohet për identifikimin e nevojave për projektet prioritare në territorin e Komunës, përgatit hartimin projekteve dhe mbikqyerjen e tyre.

Angazhohet për identifikimin e nevojave për projektet prioritare në territorin e Komunës, përgatit hartimin projekteve dhe mbikqyerjen e tyre.

Planifikon zhvillimin e planit hapësinor dhe urban të komunës, harton planet rregullative, planet për vendbanime dhe të rajone, si dhe implementimin e këtyre planeve.

Ky sektor lëshon lejet e ndërtimit, lejet për infrastrukturë (sistemit të furnizimit me ujë, kanalizimit, rrugëve, etj).

2.Sektori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

Deklarata e misionit: Administrata është përgjegjëse për të mbajtur marrëdhënie të ngushta me qeverinë qendrore-Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit. Të menaxhojë çështjet buxhetore dhe financiare të drejtorisë dhe stafit, të nxjerr politika dhe rregulla për menaxhimin e drejtorisë.

Kadastër:

Deklarata e misionit: Zyra për kadastër është përgjegjëse të kujdeset për regjistrimin e ndërrimeve, ngarkesave të patundshmërive në operatin kadastral dhe mirëmbajtjen e operatit

Gjeodezia:

Deklarata e misionit: Zyra për gjeodezi është përgjegjëse përmatje në terren të patundshmërive dhe punë të tjera gjeodezike duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve (matjet, incizimet, ndarjet, identifikime të parcelave etj.).

Pronësia:

Deklarata e misionit: Zyra për pronë është përgjegjëse për shqyrtimin e uzurpimeve të pronave, të marrë vendime bazuar në kërkesat për zgjidhjen e uzurpimeve, të jap në përdorim të përkohshëm pronën komunale, të marrë vendime për shitblerjet e pronave dhe udhëheq procedurën e eksproprijimit.

Kategoritë buxhetore

		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	67763	73102	78102
2.	Mallra dhe shërbime (për 2 sektorë)	2327	2327	2327
3.	Transfere dhe subvencione			
4.	Kapitale	1245720	2187429	2131454
TOTALI:				

Kategorit kryesore të performances

	2021	2022	2023
Kuantitative			
-Pagat janë të përlllogaritura për çdo vit për zyrtar,			

-Mallrat dhe shërbimet janë përlogaritur me vlera të përafërta me një ngritje proporcionale -Shpenzimet kapitale janë përlogaritur në duke u bazuar në të hyra vetanake të cilat janë planifikuar për projekte në infrastrukturë për shumicën e popullatës por edhe me destinim projekte për minoritete. -Do të pranohen rreth 1700 kërkesa për sektorin e Kadastrës,Gjeodezisë dhe Pronësive .Do të lëshohen 1300 dokumente mbi pronësi ,çertifikata ,kopje plani.Do të kryhen 180 ndërrime në operativ kadatral (kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë ,aktvendimeve mbi trashigiminë ,aktëgjykime civile ,regjistrim dhe fshirje të hipotekave si dhe reregjistrime të akteve juridike .Do të kryhen edhe 80 kërkesa që kanë të bëjnë me punë gjeodezike .Do të blejmë paisje gjeodezike dhe një veturë për punë në terren. -Implementimi i Kornizës së Gjellbërt Komunale në aktivitetet mjedisore.			
Kualitative			
- Investimet kapitale do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, krijimin e kushteve për ambient të pastër dhe kushte më të mira për zhvillimin e bizneseve. -Kryerja e punëve dhe detyrave në mënyrë më efektive që i përkasin drejtorisë ,ku palët do të paisen me dokumente mbi pronësinë menjëher pas dorëzimit të kërkesës. -Kryerja e shërbimeve gjeodezike (coptim ngastre,identifikim të ngastrave në zyre, relevim të objekteve në plane kadastrale) do të bëhet gjithnjë brenda afatit ligjor. -Hartimi i Planit Lokal të Veprimtarisë në Mjedis. -Zyrtarëve të drejtorisë do të ju sigurojmë kushte më të mira pune.			

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Deklarata e misionit: Krijimi i parakushteve për zhvillim ekonomik lokal, ofrimi i shërbimeve për të mobilizuar bizneset duke luajtur rol aktiv në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë së tyre ekonomike si dhe nxitje për rritje ekonomike, hapje e vendeve të reja të punës përmes përkrahjes së zhvillimit të sektorëve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe buxhet të qëndrueshëm.

Implementimi i Planit Zhvillimor Komunal 2009 - 2019

Sektori për Zhvillim Ekonomik Lokal

Deklarata e misionit: Ky sektor ka për detyrë identifikimin e nevojave të bizneseve, kryerjen e shërbimeve administrative, licencimin komunal, informatat për politikat ekonomike dhe marketingun, botime me rëndësi për aktivitetet e bizneseve, përkrahjen konkrete të bizneseve sidomos atyre fillestare përmes donatorëve të interesuar për të ndihmuar financiarisht ose materialisht si dhe këshillat nga Zyra për Përkrahjen e Bizneseve.

Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Deklarata e misionit: Ky sektor implementon politikat zhvillimore për bujqësi, koordinon dhe mbikëqyr, asociacionet bujqësore, përgatitjet e planeve për mbjelljet vjetore dhe fushata për korre - shirje, mbrojtjen e pyjeve, organizon trajnime dhe këshillime për fermerët, kujdeset për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, bashkëpunon me agjencionet qeveritare për zhvillimin e rajoneve rurale të komunës.

Kategoritë buxhetore		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	21291	26397	31397
2.	Mallra dhe shërbime	7203	2603	4603
3.	Transfere dhe subvencione			
4.	Kapitale	125000	210000	
Gjithsej				

Kategoritë kryesore të performances	2021	2022	2023
Kuantitative			
1. Pagat janë të përlogaritura për çdo vit nga 7 zyrtarë 2. Mallrat dhe shërbimet nuk janë përlogaritur për arsye se planifikimi i kësaj kategorie është koncentruar në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme për shkak të efikasitetit në procedura.			
Kualitative			
1. Shpenzimi i buxhetit në mënyrë racionale për të krijuar kushte më të mira për zhvillim ekonomik lokal. 2. Realizimi i Planit Zhvillimor Komunal 2019 - 2022 do të krijojë ambient favorizues për Zhvillimin e bizneseve vendore dhe investime të jashtme duke përfshirë edhe bujqësinë dhe zhvillimin rural 3. Zhvillimi i bizneseve vendore dhe krijimi i kushteve për investitor të jashtëm do të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Shtimes e më gjerë.			

- Sektori i Financave

Sektori i Financave

Deklarata e misionit: Nëpërmes zyrës së financave bëhet menaxhimi i buxhetit dhe financave të komunës. Bëhet përgatitja e buxhetit në bashkëveprim me drejtoritë komunale në kuadër të afateve kohore të përcaktuara nga MEF.

Bëhet menaxhimi i të hyrave dhe shpenzimeve të komunës sipas drejtorive, përgatiten raporte lidhur me të hyrat dhe shpenzimet e komunës dhe këto raporte i prezantohen KPF dhe Kuvendit, e pastaj të aprovuara i dorëzohen MEF.

Sektori i Tatimit në Pronë

Deklarata e Misionit: Menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën. Vlerësimin e pronës - tarifën e tatimit. Rianketimin e objekteve. Përgatitjen dhe lëshimin e faturave tatimore të vitit kalendarik. Regjistrimin e pagesave në PTS (program). Inkasimin e detyruar të tatimit mbi pronë - regjistrimin e pengut dhe konfiskimin e pronës. Ankesat administrative dhe përgatitja e raporte javore për MEF.

Kategoritë buxhetore		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	73719	79088	84088
2.	Mallra dhe shërbime	8742	10742	13742
3.	Transfere dhe subvencione			
4.	Kapitale			
Gjithsej				

Kategoritë kryesore të performances		2021	2022	2023
Kuantitative				
Në sektorin e buxhetit kryhen këto punë : - Përgatitja e të dhënave për hartimin e bugjetit , - Përgatitja e Kornizës Afat Mesme Buxhetore (KAB) - Përgatitja e projekt buxhetit për vitet 2021-2023 - Planifikimin e projekteve kapitale për vitet 2021-2023 Në sektorin e tatimit në prone ; Kryhen këto punë dhe detyra ; - Nxirren fatura tatimore në vit - Bëhet shpërndarja e faturave të cekura, - Bëhet regj. i pronave –objekteve të reja - Bëhet përmirësimi i faturave në bazë të ankesave të palëve, - Përgatiten dhe shpërndahen vërejtje për mospagimin e tatimit në afatën e caktuar, - Bëhet lëshimi i vërtetimeve për dëshmitë e pagesës së tatimit, Nxirren vendime mbi transferin e pronës				
Kualitative				
1. Inkasimi i të hyrave vetanake në kuadër të drejtorisë për Buxhet dhe Financa si : tatimi në prone , tarifa komunale, të hyrat nga urbanizmi , të hyrat nga katastri , të hyrat nga administrata dhe të hyrat tjera ndikon pozitivisht në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të komunës sonë , sepse mjetet e arkëtuara nga këto tatime direkt shkojnë në ngritjen e infrastrukturës si asfaltimi i rrugëve të qytetit dhe fshatrave ,ndërtimi I ujësjellësit dhe kanalizimit ,ngritjen e shkollave , ngritjen e ambullantave ,meremetimi i rr. rurale dhe projekteve të tjera që ndikon pozitivisht në zhvillimin ekon. të Komunës dhe zvogëlimin e migrimit të popullsisë nga fshati në qytet . Këto mjete kanë destinimin e caktuar për investime kapitale . Realizimi i tyre ndikon drejt për së drejti në realizimin e projekteve prioritare për komunën.				

- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)

Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim

Deklarata e misionit: Do të përmbushë nevojat për komunitet jo shumicë dhe do të angazhohet në përmbushjen e detyrave dhe dokumenteve nga niveli qendror si dhe do të bashkëpunojë me institucione

dhe organizata relevante ndërkombëtare përgjegjëse për këtë fushë.

Kategoritë buxhetore		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	15615	20693	25693
2.	Mallra dhe shërbime	382	382	382
3.	Transfere dhe subvencione	6500	6500	9500
4.	Kapitale			
5	Kumunalitë			
Gjithsej				

Kategoritë kryesore të performances		2021	2022	2023
Kuantitative				
Do të mbahen takime të rregullta mujore me organet relevante për këtë fushë				
Kualitative				
Do të ketë ndikim në krijimin e klimës dhe atmosferës së mirëbesimit dhe jetës së përbashkët midis komuniteteve që jetojnë në komunë e Shtimes.				

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenje sociale

Deklarata e misionit: DSHMSMCE ka për mision të vetin të sigurojë dhe zhvillojë sistemin e ofrimit të mbrojtjes parësore shëndetësore sa më kualitative, duke u bazuar në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës sonë, si përkujdesjen sociale të të gjithë banorëve, veçmas të atyre me status të rëndë social, gadishmërinë për mbrojtje civile dhe rasteve emergjente kuptohet, gjithmonë sipas mundësive buxhetore e kadrovike.

Administrata

Deklarata e misionit: Administrata është përgjegjëse për sigurimin e personelit të drejtorisë me udhëzime, politika dhe procedura për menaxhimin dhe implementimin e aktiviteteve, menaxhimin e buxhetit dhe të financave të drejtorisë.

Zyra për shëndetësi

Deklarata e misionit: Qëllim kryesor i sektorit të shëndetësisë është të kujdeset për kujdesin parësor shëndetësor të qytetarëve të komunës dhe të kujdeset për shëndetin e përgjithshëm publik.

Zyra për politika sociale

Deklarata e misionit: Në bazë të kërkesave të qytetarëve me gjendje të rëndë sociale dhe në bazë të propozimeve të komiteteve të fshatrave bëhet përpilimi i listave për dhënjen e ndihmës sociale këtyre familjeve me gjendje të rëndë sociale. E gjitha kjo bëhet me anë të identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes sociale të familjeve të propozuara dhe që kanë kërkuar ndihmë sociale.

Shërbimt Sociale dhe Rezidenciale

Deklarata e misionit: Shërbimet Sociale nga Marsi i vitit 2009 janë kompetencë e bartur nga niveli qendror. Përkrahje financiare nga përfituesit e skemës sociale do jetë e kordinuar me drejtorinë me qëllim të hulumtimit të ndihmave edhe nga komuna, donatorët si dhe mundësinë e ofrimit të punëve sezonale.

Kategoritë buxhetore		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	730408	739060	744060
2.	Mallra dhe shërbime	281425	392031	412031
3.	Transfere dhe subvencione	50234	50234	70000
4.	Kapitale	60000	40674	190000
5.	Komunali	28900	34900	37900
	Totali:			

Kategoritë kryesore të performances	2021	2022	2023
Kuantitative			
1. Do të bëjmë kompletimin e teknologjisë informative me program softverik			
2. Do të bëjmë meremetimin e objektit të QKMF-së dhe të objekteve në Pjetërshticë dhe Muzeqinë.			
Kualitative			
1. Kompletimi i teknologjisë informative do të rrisë efikasitetin në punë si në aspektin statistikor, informative, si dhe pasqyrim të gjendjes shëndetësore të pacientëve në raport me mjekun e tyre familjar. 2. Meremetimi i objektit të QKMF-së do të krijoj kushte për punë të personelit mjekësor dhe do të rritë kualitetin e shërbimeve mjekësore për pacientët..			

Drejtoria për Arsimit

Deklarata e Misionit: DAK ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj në bazë të ligjit lidhur me organizimin e arsimit për fëmijët dhe të rriturit. Nxitë barazinë në mundësinë për të ndjekur arsimin parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunë, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit si dhe në të gjitha aspektet e tjera të arsimit. Respekton dhe nxitë të drejtën e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre. Nxitë bashkëpunimin midis mësuesve, prindërve, nxënësve dhe midis institucioneve arsimore dhe familjes. Bënë regjistrimin e të dhënave personale të nxënësve në një format të miratuar nga MASHT dhe në harmoni me nenin 10.2 (b) të LAFM. Bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Inspektorëve të Arsimit për çështje të ndryshme të arsimit në komunë, që kërkohet bashkëveprim dhe përgjigje e të dy palëve.

Administrata

Deklarata e Misionit: Të sigurojë barazinë e mundësisë për të ndjekur arsimin parashkollor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të të gjithë qytetarëve të komunës, përfshirë edhe pakicat/minoritetet, të mbështesë zhvillimin dhe aftësimin e personelit, të nxisë bashkëpunimin midis mësimeve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore. Të jap udhëzime personelit dhe të menaxhojë me asetet e drejtorisë në mënyrë sa më të mire, si dhe të sigurojë shërbimet e duhura për funksionimin sa më të mirë të arsimit në komunë.

Koordinatori

Deklarata e Misionit: ndihmon Drejtorinë në kryerjen e punëve profesionale arsimore – edukative dhe të përgjithshme nga fushëveprimtaria e DKA. Të koordinojë punët në relacionin DKA – shkollë dhe anasjelltas. Planifikimi i aktiviteteve për zhvillimin e procesit arsimor në institucionet komunale, të zbatojë politikat e MASHT në institucionet arsimore të komunës, të koordinojë punën mes tri zyrave tjera të drejtorisë.

Zyra e Arsimit

Deklarata e Misionit: Është përgjegjës për planifikimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e procesit arsimor në institucionet arsimore në komunë, identifikimin e nevojave të institucioneve arsimore në komunë, sigurimin e përfshirjes së të gjithë fëmijëve në institucionet e arsimit të komunës, etj.

Zyra për Administratë dhe Financa

Deklarata e Misionit: Njësia administrative është përgjegjëse për punët administrative të drejtorisë, krijimin, dërgimin dhe mbajtjen e dokumentacionit sipas protokollit në DKA, mbajtjen e procesverbalit për DKA përpilimin e vendimeve të ndryshme, krijimin dhe mbajtjen e dosjeve të punëtorëve të arsimit në komunë, përgatitjen e konkurseve për punësim, mbledhjen e të dhënave statistikore për nxënës dhe punëtorë të arsimit.

Njësia e financave është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit, për të gjitha shkollat e komunës, rishikimin e buxhetit, planifikimin e shpenzimeve sipas kategorive, lejimin e pagesave me para të gatshme, mban shënime për fondet e pranuar nga donatorët, kontrollon shpenzimet e shkollave

Zyra për Shërbime Teknike

Deklarata e Misionit: Siguron procedurat dhe mjetet për transportin e fëmijëve në shkollë, bënë planifikimin e furnizimit të shkollave me inventar, lëndë djegëse, mjete mësimore dhe mjete të punës, mbanë shënime për inventarin, mjetet mësimore dhe llojet e tyre në shkolla, udhëheq të gjitha procedurat ligjore për sigurimin e pronës.

Kategoritë buxhetore		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	2755608	2779386	2799386
2.	Mallra dhe shërbime	211924	211924	226585
3.	Transfere dhe subvencione	20000	20000	20000
4.	Kapitale	228490	200000	300000
5.	Shpenzime Komunale	103417	150000	150000
Totali				

Kategoritë kryesore të performances	2021	2022	2023
Kuantitative			
- Pagat janë llogaritur për 456 punëtorë arsimor.			
- Kategoria mallra dhe shërbime në krahasim me vitin 2021 do të ketë rritje kuantitative.			
- Kategoria transfere dhe subvencione në vitin 2021 është planifikuar të jetë 20.000€			
- Në vitin 2021 do të ketë projekte kapitale			
- Shpenzimet komunale për tri vitet do të jenë të njëjta.			
Kualitative			
Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit			

Drejtoria e Inovacionit dhe Zhvillimit të Projekteve

Drejtoria e Inovacionit dhe Zhvillimit të Projekteve

Deklarata e misionit: Qëllimi i Drejtorisë së Inovacionit dhe Zhvillimit të Projekteve është ofrimi i një hapsire inovative ku nxënësit, studentet dhe të gjithë qytetarët me ide dhe njohuri të reja që krijojnë vlerë inovative do të zhvillojnë projektin e tyre, do të avancohen për tregun dhe do të punojnë veprimtarinë e tyre me sukses duke e bërë një qendër të gjallë ku njerëzit duan të jetojnë dhe punojnë dhe misioni është të zhvillohen resurset humane duke krijuar vende të punës, shfrytëzim të burimeve njerzore dhe natyrore në krijimin e projekteve inovative duke bërë nderlidhjen mes institucioneve shtetërore dhe klubeve të bizneseve.

Kategoritë kryesore të performances	2021	2022	2023
Kuantitative			
Në sektorin e Inovacionit dhe Zhvillimit të Projekteve kryhen këto punë : -Rregullimi i hapsirave inovative, - Përgatitja e Planit të Punës - Përgatitja e projekt propozimeve për investime - Planifikimin e projekteve kapitale për vitet 2021-2023			
Kualitative			
1.Arritja e marrëveshjeve me sektorin privat dhe realizimi i projektve në praktik nga fokus grupet. Përdorimi i paisjeve në përgaditjen e ideve inovative të cilat kanë kosto dhe sjellin të hyra nga realizimi i tyre përmes marrëveshjeve publiko-private.			

Drejtoria për Prokurim Publik

Drejtoria për Prokurim Publik
Deklarata e misionit: Të siguroj mënyren më efikase , më transparente dhe më të drejtë të shrytëzimit të fondeve publike , burimeve publike duke përcaktuar kushte dhe rregulla që do të zbatohen të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat operatorët ekonomik,ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që marrin pjesë në aktivitetet e prokurimit , duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas të fondeve publike.

Kategoritë buxhetore	2021	2022	2023
1. Paga dhe mëditje	29065	34210	39210
2. Mallra dhe shërbime			
3. Transfere dhe subvencione			
4. Kapitale			
Gjithsej			

Kategoritë kryesore të performances	2021	2022	2023
Kuantitative			
Drejtoria e Prokurimit Publik * Në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetor të prokurimit. * Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit * Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve * Partecipon në Negocime të Tenderëve dhe siguron rezultate të drejta * Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht * Këshillon njësitë kërkuuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit * Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive * Përgatit dhe publikon dhënien e kontratave * Përcjellë dështimet e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e dhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave * Organizon dhe menaxhon kuotimet dhe tenderët varësisht nga çmimi i parashikuar * Përcjellë dështimet e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e dhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave * Harton një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara dhe dorzon në KRPP * Nxjerr urdhërblerje për secilën pagesë dhe dërzohen në financa për ekzekutim			

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Kultura, Rinia dhe Sporti	
Deklarata e Misionit: Ngritja e nivelit të kulturës, rinisë dhe sportit. Përmes kësaj zyre do të planifikohen dhe implementohen të gjitha aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive në komunën tonë.	

Kategoritë buxhetore		2021	2022	2023
1.	Paga dhe mëditje	54491	59763	64763
2.	Mallra dhe shërbime	18350	22350	27350
3.	Transfere dhe subvencione	33500	33500	50000

4.	Kapitale	7000	10000	12000
5,	Shpenzime Komunale	188000	50000	
Totali				

SHKURTESAT

BPV – Bruto Produkti Vendor

IÇK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit

KABK - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale

PIP - Programi i Investimeve Publike

GQ - Granti Qeveritarë

GA - Granti i Arsimit

GSH - Granti i Shëndetësisë

HV - Të Hyrat Vetanake të Komunës së Shtimes



KRYESUESJA E KUVENDIT
MEDINA BRAHAJ